



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:279789

Datë: 11.12.2023

Numri i

05044899

dokumentit:

P.nr.1041/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale ndaj të pandehurit A.R.nga fshati L K. Pejë ,për shkak se ka kryer vepër penale „ Kanosja’’ nga neni 181 par.3. lidhur me par.1 të KPRK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm nën shenjë PP/II.nr.2348/21 të dt.15.12.2021, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit fillestar me datë 16.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Pejë, Ermal Demhasaj, të pandehurit A.R.dhe mbrojtësit të pandehurit me autorizim av. Arben Kelmendi nga Peja, me datë 17.11.2023 morri dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 11.12.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

A.R. nga i ati R dhe nëna J e vajzërisë B, i lindur me, në Deçan , me vendbanim në Pejë Rr. „Gj.G.,’’hyrja nr.4 ,ka të kryer shkollën e mesme, me profesion, i martuar baba i..... fëmije, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet në bazë të letërnjoftimit me nr. personal të lëshuar nga MPB të R. Kosovës, posedon nr. telefoni, shqiptar, shtetas i R. Kosovës , gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Me datë.,rreth orës 17:10 min. ne ,, , seriozisht, me fjalë e kanos zyrtarin ne lidhur me punën e tij se do ti shkaktojë ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit dhe atë të dëmtuarin Radiologun Sh.M.,në atë mënyrë që, pasi qe i dëmtuari e kishte ekzaminuar ne EHO bashkëshortet e te pandehurit ku edhe kishte lëshuar raportin me qëllim te paraqitet tek doktori

adekuat, dhe pas ekzaminimit shkon i pandehuri tek zyra e te dëmtuarit dhe i drejtohet me fjale „Pse nuk po i kallëzon gruas time çka ka” , e pastaj i drejtohet me zë te lartë duke i thënë „ A e din ti kush jam unë dhe ke me pa nëse i ndodh diçka gruas time pastaj shihemi” , aty ndërhyjnë dëshmitaret dhe largojnë te pandehurit , ndërsa tek i dëmtuari shkakton frik dhe panik me ç ‘rast edhe e raporton rastin ne Polici.

-me çka ka kryer vepër penale „**Kanosja**” nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, nenit 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së , dhe nenit 364, 365, 452 par.1 të KPPRK-së, gjykata të pandehurit A.R. i shqipton:

- I. Me **dënim me burgim** ne kohëzgjatje prej **njëqind e tetëdhjetë (180) muaj**, i cili dënim në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit, i është zëvendësuar me:

DËNIM ME GJOBË në shumen prej **katërqind (400,00) euro**, e të cilin dënim i njëjti obligohet ta paguaje në afat prej **nëntëdhjetë (90) ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- II. Nëse i njëjti refuzon, dështon apo nuk paguan dënimin e shqiptuar me gjobë në afatin e caktuar, ky dënim do të zëvendësohet me dënim burgimi duke i llogaritur shumen prej 20 (njëzetë) euro për një ditë burgimi. Nëse i njëjti nuk dëshiron ose nuk mund të paguaje gjobën në tërësi, gjykata do ta zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me burgim. Nëse i njëjti e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit me burgim ndërpritet.
- III. I pandehuri obligohet që gjykatës ti paguan shpenzimet e procedurës penale dhe atë paushallin gjyqësor ne shumë prej **tridhjetë (30) euro**, dhe shumë prej **njëzetë (20) euro** ne emër te fondit për kompensimin e viktimave te krimit.
- IV. Pala e dëmtuar Sh (XhM me vendbanim në Pejë Rr., M.P..1/6, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjë PP/II. nr.2348/21 dt.15.12.2021, kundër të pandehurit A (R) R, për shkak të veprës penale „Kanosja” nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 16.11.2023, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ermal Demhasaj, të pandehurit A.R., mbrojtësit të tij av. Arben Kelmendi sipas autorizimit e në mungesë të dëmtuarit SH.M.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPPRK-së, e ka udhëzuar të pandehurin në të drejtat e tij.

I pandehuri i vetëdijshëm për natyrën , përparësitë dhe pasojat e pranimi të fajësisë, deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë dhe atë e bënë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që pranimi i fajësisë nga i pandehuri është bërë në mënyrë vullnetare pa presion dhe ka mbështetje në shkresat e lëndës.

Ndërkaq mbrojtësi e të pandehurit, lidhur me pranimin e fajësisë deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë, ishte pranimi i vullnetshëm pa presion andaj i propozoj gjykatës që të njëjtën ta miratoj.

Gjykata konform nenit 242 par.6 të KPPRK-së, pas dëgjimit të palëve të cilët u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, e ka miratuar pranimin e fajësisë pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së, pasi që i pandehuri e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë : Raporti i Oficerit A.SH dt.27.09.2021.Deklarata te dëmtuarit Sh.M.e dhënë ne Polici me dt.27.09.2021.Deklarata e dëshmitarit D.L e dhënë ne Prokurori me dt.13.12.2021.Deklarata e te pandehurit A.R.e dhënë ne Prokurori me dt.14.12.2021.

Prokurori i shtetit, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit në kuptim të këtyre rrethanave i propozoj të veproj konform dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPPRK-së ,ashtu që propozoj qe si rrethanë lehtësuese te merret parasysh pranimi i fajësisë ,ndërsa si rrethanë rënduese te merret parasysh dënimet eventuale të më hershme.

Mbrojtësi i të pandehurit, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë i propozoi gjykatës që pranimin e fajësisë gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese si dhe faktin se i mbrojturi i tij për herë të parë të parë ka ra ndesh me ligjin duke shtuar se i mbrojturi i tij ditën kritike nuk ka pas qëllim në asnjë mënyrë ta kanos këtu të dëmtuarin respektivisht doktorin i cili ishte duke e trajtuar bashkëshorten e tij të sëmurë dhe i mbrojturi i tij ka kërkuar nga i dëmtuari si doktor të tregoj kujdes më të shtuar dhe se reagimet e tij verbale kanë qenë rezultat i frikës për jetën e bashkëshortes së tij. Mbrojtja gjithashtu kërkoj nga gjykata ta merre parasysh edhe gjendjen ekonomike të të mbrojturit i tij, ngase kostoja e shërimit të bashkëshortes është i lartë dhe i pa përballueshëm në aspektin financiar.

I pandehuri deklaroi se pajtohet me fjalën e mbrojtësit të tij duke shtuar se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhë.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të akuzuarit A.R., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Kanosja” nga neni 181 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri është i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së gjykata si rrethana lehtësuese për të pandehurin, morri parasysh pranimin e fajësisë, pendimin e tij për atë çfarë ka ndodh në ditën kritike, faktin se për të pandehurin është hera e parë që bie ndesh me ligjin si dhe gjendjen e vështirë ekonomike të tij, kurse si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata nuk gjeti.

Gjykata fillimisht i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditë, dhe njëkohësisht në kuptim të nenit 44 par. 1 dhe 2 të KPRK-së i ka dhënë mundësinë që ky dënim të zëvendësohet me dënim me gjobë, ashtu që i njëjti përmes mbrojtësit të tij pas shpalljes, e po ashtu me parashtrësën e datës 20.11.2023, e cila gjendet në shkresat e lëndës, ka dhënë pëlqimin e tij për zëvendësimin e dënimit me burgim me dënim me gjobë ashtu siç është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata të pandehurin e gjykoi si në piken I të dispozitivit të këtij Aktgjykimi.

Vendimi për zëvendësimin eventual e dënimit të shqiptuar me gjobe me dënim burgimi në rast se i pandehuri dështon apo refuzon ta paguan dënimin me gjobë u morr konform nenit 43 par. 3 dhe 4 të KPRK-së.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata e morri konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPPRK-së,

Konform nenit 462 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarën, gjykata e udhëzoi në kontest juridiko civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloj këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Departamenti i Përgjithshëm

Divizioni Penal

P.nr.1041/21, me datë 11.12.2023

Bashkëpunëtore profesionale

Gjyqtare e vetme gjykuese

Gylaj Nepola

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.